

## Njoftim

Sot, më datë **13.04.2023, ora 15:00**, trupi gjykues i Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, i përbërë nga gjyqtarët:

- 1. Marsela Dervishi (Relatore);**
- 2. Esmeralda Xhili (Anëtare);**
- 3. Emona Muçi (Anëtare);**
- 4. Blerona Hasa (Anëtare);**
- 5. Alma Kolgjoka (Anëtare).**

në seancë gjyqësore të zhvilluar në ambientet e Gjykatës Administrative të Apelit, në adresën: Rr“Ismail Qemali”, Tiranë, salla 2, pasi shqyrtoi çështjen Nr.9 Regj.Themeltar, datë 07.04.2023 Regjistrimi, me:

**Paditës:** Subjekti Zgjedhor Partia Nisma Thurje, përfaqësuar nga Kryetari, z.  
Indrit Shabani.  
Kosta Garo.

**I paditur:** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

**Objekti:** Ndryshimin e Vendimit nr.10, datë 28.03.2023 të KZAZ-së Nr.82, dhe Vendimit Nr.43, datë 03.04.2023 të Komisionit të Apelimeve dhe Sanksioneve.  
Detyrimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të vendosë regjistrimin e subjektit Partia Nisma Thurje dhe kandidatit Kosta Garo si kandidat për kryetar i Bashkisë Dropull në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023.

**Baza ligjore:** Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 45; Ligji nr.10019, datë 29.12.2008 (i ndryshuar), Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Nenet 68, 73, 124 dhe 126, 145; Kodi i Procedurave Administrative të RSH, nenet 130 dhe 131; Udhëzimi nr.1, datë 18.01.2023 i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, neni 12.

me Vendimin Nr.9, datë 13.04.2023, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, unanimisht,

**Vendosi:**

1. Pranimin e padisë.
2. Shfuqizimin e Vendimit nr.43, datë 03.04.2023 të Komisionit të Apelimeve dhe Sanksioneve dhe Vendimit nr.10, datë 28.03.2023 të KZAZ-së Nr.82.
3. Detyrimin e KQZ/KZAZ nr.82 të regjistrojë si kandidat për kryetar të Bahkisë Dropull z.Kosta Garo, të paraqitur nga subjekti zgjedhor “Nisma Thurje”.
4. Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës së paditur.
5. Ky vendim është i formës së prerë dhe ndaj tij nuk lejohet ankim.
6. U shpall në Tiranë më datë 13.04.2023.

**Tiranë, më 13.04.2023.**

**Gjykata Administrative e Apelit Tiranë**